



WWF-Spain / Jesus Cobo
For private use only - No reproduction or commercial use allowed

Rrëqebulli i Ballkanit në rrezik zhdukjeje

Shoqata për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri ndërmerr "Programin për Rikuperimin e Rrëqebullit të Ballkanit".

Pyjet e Shqipërisë, edhe pse të dëmtuara ndër vite duket se ende fshehin thesarë të pazbuluara që mund të mahnitin këdo. Një ndër to është dhe rrëqebulli, një kafshe mëstike, që i ka shpëtuar vëmendjes së njerëzve për shumë kohë. Pak kush ka dëgjuar të flitet për rrëqebullin. Janë edhe më të trallë ata që mund të krenohen se kanë parë një të tillë. Ai endet në pyjet e maleve të larta të Shqipërisë i rrethuar nga misterë dhe legjenda. Rrëqebulli, i njohur në gjuhën shkencore si *Lynx lynx*, është mishngrënësi i tretë për nga madhësia në Evropë, pas ariut dhe ujkut. Bën pjesë në familjen e maceve (*Felidae*) dhe ka përhapje në Euroazi, nga Alpet e Evropës deri në Siberinë Lindore. Në Shqipëri haset kryesisht në zonat malore veriore dhe qendrore si në Alpe, Pukë, Lurë, Martanesh e Librazhd. Parapëlqen pyjet e larta dhe pak të shkelura nga njerëzit.

Ka pamje mjaft karakteristike, me trup të mbledhur dhe këmbë të gjata e me shputa të gjera. Ka kokë të rrumbullakët, veshë të mëdhenj me një xhufkë tipike qimesh në majë, bisht të shkurtër dhe me majë të zezë. **Gëzofin** e ka ngjyrë kafe në të kuqërremetë, që vjen duke u zbardhur në pjesët e poshtme të barkut dhe është jmbuluar me pulla të errëta. Është i gjatë 80-130 cm, i lartë rreth 65 cm dhe peshon 12-35 kilogramë. Ushqehet kryesisht me thundrakë, si kaprolli dhe dhia e egër, por në dietën e tij nuk mungojnë dhe lepuri i egët, dhelpra dhe shpendë të ndryshëm të pyllit. Është kafshë tipike vetmitare dhe takohet me rrëqebuj të tjera vetëm në sezonin e çiftimit. Zë territorë të mëdha (deri 2000 km²) dhe është aktiv kryesisht natën. Brenda një nate mund të përshtkojë deri 45 km. Rrëqebulli jeton deri 17 vjet.

Rrëqebulli i rrezikohet në Ballkan-

Sipas Shoqatës për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri, vlerësimet paraprake për popullatën autoktone të rrëqebullit në Ballkanin jugperëndimor tregojnë se popullata e tij në këtë hapësirë është më e rrezikuar krasuar me pjesën tjeter të planetit. Situata bëhet edhe më alarmante po të mendohet se rrëqebulli i Ballkanit konsiderohet si subspecies më vete, *Lynx lynx martinoi*. Gjendja e tij nuk njihet mirë, por numri i gjithë populatës mendohet të jetë nën 100 individë e përgjendruar kryesisht në Shqipëri dhe Maqedoni. Nga të dhënat e deritanishme, mendohet se në Shqipëri jetojnë 20-25 individë rrëqebujsht. Shoqata për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri ka udërmarrë një projekt lidhur me mbrojtjen e Rrëqebullit të Ballkanit. Sipas kësaj shoqata në këtë nismë marrin pjesë organizata ndërkombëtare si Grupi Specialist i Maceve të Egra të Botës (IUCN SSC/Cat Specialist Group), Organizata Zvicerane për Menaxhimin e Mishngrënësve të Mëdhenj (KORA), Fondi Evropian për Trashëgiminë Natyrore (Euronatur) dhe Institutu Norvegjez për Kërkimet Mjedisore (NINA). Në nivelin rajonal, zbatuase të projektit do të janë Shoqata për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA) dhe Shoqata Ekologjike Maqedonase (MES). Projekti shumëpalesh i njohur si "Programi për Rikuperimin e Rrëqebullit të Ballkanit" në fazën e parë synon ndalimin e rënies së mëtejshme të popullatës së rrëqebullit nëpërmjet studimit dhe monitorimit të species, sensibilizimit publik, forcimit të kuadrit ligjor dhe shpaljen e zonave të mbrojtura. Në një periudhë më afatgjatë pritet të konksretizohet një Plan Veprimi për species dhe të konsolidohet një Qender Monitorimi Kombëtar për Mishngrënësit e Mëdhenj në bazë të eksperiencës së vendeve partnerë në projekt.